

KOLEKTORI I RI I NË GJIRIN E LALËZIT

Me një investim prej 10 milionë eurosh është bërë e mundur ndërtimi i Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në zonën turistike të Gjirit të Lalëzit. Në fazën e parë, kjo vepër do të mbulojë nevojat e 15 mijë banorëve, për t'u zhvilluar në të ardhmen në një kapacitet përpunues për 30 mijë banorë. Kjo vepër parashikohet t'i jap zgjidhje menaxhimit të ujërave të zeza deri në vitin 2030. Kolektori i ujërave të zeza përfshin dhe ndërtimin e rrjetit kryesor të kanalizimeve me rreth 6.2 km rrjet kanalizimi kryesor si dhe 4 stacione pompimi.

ROAMING BALLKANIK

Në Samitin Dixhital të mbajtur në Beograd, 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia, firmosën marrëveshjen që i hap rrugën zerimit të tarifave Roaming. Marrëveshja do të ulë kostot duke filluar nga korriku i këtij viti, duke i hapur rrugën "Fol si n'shpi (RLAH) me kosto zero në vitin 2021. Marrëveshja është në të njëjtën linjë me BE, ndërsa do të ketë impakt direkt tek qytetarët e Ballkanit Perëndimor.

PUNIMET PËR BYPASS-IN E FIERIT

Njëra nga karrexhatat e ByPass-it të Fierit do të jetë e aksesueshme nga automjetet përpara nisjes së sezonit turistik. Punimet janë duke ecur me ritme të shpejta dhe synohet që njëri krah i kësaj nyjeje të rëndësishme për trafikun drejt jugut të vendit, të jetë gati në fund të muajit qershor. 240 punonjës, janë angazhuar nga kompania për përfundimin në kohë të punimeve ndërsa ato vijojnë edhe gjatë natës. Aktualisht po punohet për ndërtimin e tri urave, asaj të Hoxharës, Semanit dhe Pojanit, në dy prej të cilave pritet që brenda muajit prill të vendosen strukturat metalike.

LEHTËSI NË SHËRBIME PËR SUBJEKTET

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ofron të tjera lehtësi për subjektet. Përmes aplikimit online mund të përfitohet certifikatë për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Udhëtarëve, duke lehtësuar në këtë mënyrë 169 subjekte dhe 436 mjete. Gjithashtu ulet numri i shërbimeve nga 1307 që është aktualisht në 436 si dhe numri i dokumenteve nga 20 në 9. Të tjera përfitime janë verifikimi në sistem dhe jo më përmes letrave, njehsimi i dokumenteve falas nga DPSHTRR si dhe rritja e vlefshmërisë së certifikatës nga 1 në 5-vjeçare.

NIS PUNA PËR AEROPORTIN E KUKËSIT

Ka nisur puna për ndërtimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Kukësit, i cili synon të kthehet në një pikë referimi për gjithë rajonin. Punimet civile do të zgjasin 12 muaj, ndërsa afati i nisjes së operimit është 24 muaj. Nga studimet paraprake parashikohet që ky aeroport të ketë një fluks lëvizjeje rreth 300 mijë pasagjerësh në vit, me rritje të ndjeshme në vitet pasuese. Synimi është që përmes çmimeve të ulëta ky aeroport të shërbejë si pikë referimi në funksion të lëvizies raionale të udhëtarëve.

MASA PËR RRITJEN E SIGURISË RRUGORE

Ka vijuar puna për rritjen e sigurisë rrugore në disa prej akseve në vend. Në aksin Kamëz-Fushë Krujë, puna u fokusua në përmirësimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale në kryqëzimet që ndodhen përgjatë këtij segmenti rrugor. Puna po vijon për përmirësimin e sinjalistikës në kryqëzimet e Tapizës, Qerekës dhe Dritas. Gjithashtu me synim garantimin e sigurisë maksimale për udhëtarët u vendos sinjalistika horizontale dhe vertikale në tunelin e Shkopetit dhe pjesën tjetër të aksit.